



MINISTRIA EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA E MESME PROFESIONALE "KRISTO ISAK" BERAT

Nr. 669 prot.

Berat, më 30.09.2025

Lënda: Njoftim për vend të lirë

DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE

DREJTORISË SË MARDHËNIEVE ME PUBLIKUN

AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Në zbatim të Ligjit nr. 15/2019 "Për nxitjen e Punësimit", Ligjit nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 554, datë 31.07.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive", si dhe Udhëzimit nr. 759, datë 30.09.2024 "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional", Kreu XXII, Neni 120 "Shpallja e vendit të lirë për personel mësimdhënës të kulturës profesionale me kohë të plotë",

Shkolla e Mesme Profesionale "Kristo Isak" ju njofton krijimin e vendit të lirë të punës për pozicionin:

- 1- Mësimdhënës i Teorisë dhe Praktikës profesionale, drejtimi Hoteleri-Turizem & Ekonomi Biznes (me kontratë me afat).

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme për lëvizjen paralele si vijon:

- m) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- n) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- o) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- p) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- q) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- r) të demonstrojë aftësi për punën në grup dhe motivimin.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- 9- të ketë diplomë të nivelit "Master Profesional" ose të barasvlefshme në të njëjtën fushë me njërin nga kualifikimet profesionale të ofruesit publik të AFP-së;
- 10- të ketë të paktën 1 (një) vit përvojë pune në fushën në të cilën ka kryer studimet;
- 11- të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit;
- 12- të njohë dhe të përdorë programe financiare (Financa 5 do të jetë përparësi).

Adresa: "Rruga Desaret"
kristoisak_berat@yahoo.com
Lagja: "Jani Vruho, Berat"

web: kristoisak.edu.al

Email:

Tel: +355 (0)32 50 2192

4. Dokumentat e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- w) letërmotivimin për pozicionin;
- x) jetëshkrimin (CV-në) sipas modelit Europass;
- y) kopjen e kartës së identitetit;
- z) diplomën e studimeve universitare;
- aa) librezën e punës;
- bb) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- cc) certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- dd) vërtetimin e gjendjes shëndetësore;
- ee) vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
- ff) vërtetimin nga punëdhënësi i fundit që ndaj tij nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- gg) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP-së, brenda datës

08.10.2025

2. Vlerësimi i kandidatëve

Vlerësimi i kandidatëve do të bëhet referuar përcaktimeve të Udhëzimit nr. 759, datë 27.05.2024 "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë, menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjen e Njesisë së Zhvillimit të institucioneve ofruese të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit", i ndryshuar.

DREJTORI I SHKOLLËS

Ferik KOÇI



Adresa: "Rruga Desaret"
kristoisak_berat@yahoo.com
Lagja: "Jani Vruho, Berat"

web: kristoisak.edu.al

Email:

Tel: +355 (0)32 50 2192